



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 625/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 28.08.2017 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: “Modifikimi i dokumentave të procedurës së prokurimit me Nr.REF-19873-07-07-2017 me objekt: “*Sherbime printimi fotokopjimi dhe skanimi, color e bardh e zi format A 4*”, me fond limit limit 1.658.000 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 20.07.2017 nga autoriteti kontraktor Bashkia Lezhë.”

Ankimues: “PC Store” sh.p.k
Rrga e Dibrës, Vila 154
Tiranë

Autoriteti kontraktor: Bashkia Lezhë,
Lagje Skenderbeg, Lezhë

Baza Ligjore: *Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 10.07.2017 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit me Nr.REF-19873-07-07-2017 me objekt: “*Sherbime printimi fotokopjimi dhe skanimi, color e bardh e zi format A 4*”, me fond limit limit 1.658.000 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 20.07.2017 nga autoriteti kontraktor Bashkia Lezhë.

II.2. Në datën 14.07.2017 operatori ekonomik “PC Store” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor. Në ankesë ngrihen pretendime lidhur me hartimin e dokumentave të tenderit të mësipërm. Konkretisht pretendohet si vijon:

I. “Kompania jonë “PC Store” sh.p.k nuk është dakort me pikën 2 të Kapaciteti Teknik, Kriteret e Vecanta të Tenderit të hartuara nga njësia e prokurimit të AK-së dhe përkatësisht:

“Operatori ekonomik duhet të jetë distributor i autorizuar nga kompania prodhuese e markave XEROX dhe RICOH për territorin e Republikës së Shqipërisë, kjo për arsye se pajisjet që disponon Bashkia Lezhë dhe njësitë administrative përbërëse janë pikërisht të këtyre markave.”

[...] Ne gjykojmë se kërkesa e percaktuar nga autoriteti kontraktor se “operatori ekonomik duhet të jetë distributor i autorizuar nga kompanitë prodhuese të markave XEROX dhe RICOH për territorin e Republikës së Shqipërisë”, kufizon konkurrencën, duke lejuar vetëm një numër të kufizuar shoqërisht të jenë pjesëmarrëse dhe më saktë nga vetën 1 (një)

kompani “Kallfa”, e cila është distributori i vetëm për markat XEROX dhe RICOH në Shqipëri [...].

Në këtë kuptim AK duhet të modifikojë kriterin si vijon: “Autorizim i kompanisë prodhuese ose distributorit të tij që operatori ekonomik ofertues është i autorizuar për të kryer këtë shërbim në këtë procedurë.”

Ndërkohë duke qenë se AK është një institucion i rëndësishëm dhe me informacione konfidenciale mendojmë që dhe paraqitja e certifikatave të mëposhtme është i nevojshëm:

- a) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën e tij që vërteton se sistemi i manaxhimit të cilësisë është sipas standardit ISO 9001:2008, objekti i së cilës të ketë lidhje me objektin e prokurimit.
- b) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën ISO 27001 për sigurinë e informacionit. Objekti i certifikatës duhet të jetë i ngjashëm me objektin e prokurimit.

2. Kompania jonë PC Store nuk është dakort me pikën 4 të Kapaciteti Teknik, Kriteret e Vecanta të Tenderit, të hartuara nga njësia e prokurimit të AK-së dhe përkatësisht:

“Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se ka të punësuar minimalisht 10 persona, nga këta 7 persona duhet të jenë me diploma inxhinier (IT, megatronik, inxhinier elektronik etj) për të cilët duhet të paraqesë:

1. CV personale
2. Diploma personale e fakultetit
3. Kontrata e punës për secilin profil (me afat, të paktën deri në përfundim të shërbimit objekt prokurimit).”

[...] Duke parë se lista e pajisjeve në përdorim nga AK, janë gjithsej:

- RIKOH- (MP 161 SPF, MP 171 SPF) -- 2 copë
- XEROX- (e tipit nr.5222, nr.5225, nr.5230) -- 3 copë

Pra në total janë 5 (pesë pajisje) dhe duhet në total 7 inxhiniera (IT, megatronik, inxhinier elektronik etj.,) nuk është në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Në këtë kuptim AK duhet të modifikojë kriterin si vijon:

“Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se ka të punësuar minimalisht 10 persona, nga këta 3 persona duhet të jenë me diploma inxhinier (IT, megatronik, inxhinier elektronik etj) për të cilët duhet të paraqesë:

1. CV personale
2. Diploma personale e fakultetit.”

3. Kompania jonë PC Store nuk është dakort me pikën 2 të Kapaciteti Teknik, Kriteret e Vecanta të Tenderit të hartuara nga njësia e prokurimit të AK-së dhe përkatësisht:

“Stafi i punonjësve duhet të jetë i certifikuar për mirëmbajtjen e pajisjeve për markat e pajisjeve RICOH dhe XEROX. Certifikata e trajnimit për stafin teknik duhet të jetë e lëshuar

detyrimisht nga prodhuesi i markës RICOH dhe XEROX (3 Specialistë të certifikuar për mirëmbajtjen e pajisjeve RICOH; 3 Specialistë të certifikuar për mirëmbajtjen e pajisjeve XEROX)”

[...] Duke parë se lista e pajisjeve që janë në përdorim nga AK janë gjithsej:

- RIKOH- (MP 161 SPF, MP 171 SPF) -- 2 copë
- XEROX- (e tipit nr.5222, nr.5225, nr.5230) -- 3 copë

Vendosja e kriterëve (3 Specialistë të certifikuar për mirëmbajtjen e pajisjeve RICOH; 3 Specialistë të certifikuar për mirëmbajtjen e pajisjeve XEROX) nuk është në përpjestim me sasinë e pajisjeve duke qenë se në total janë 5 pajisje.

[...] Në sa më sipër, referuar nenit 23 të LPP-së AK duhet të shtojë togfjalëshin “ose ekuivalent” duke mundësuar një konkurrim të drejtë të hapur dhe gjithpëfshirës [...].

Në këtë kuptim AK duhet të modifikojë kriterin si vijon:

“Stafi i të punësuarve duhet të jetë i certifikuar për mirëmbajtjen e pajisjeve për markat e pajisjeve RICOH dhe XEROX ose “ekuivalente”.

Certifikatat e trajnimit për stafin teknik duhet të jetë lëshuar detyrimisht nga prodhuesi i markës RICOH dhe XEROX ose “ekuivalent”.

II.3. Në datën 19.07.2017, nëpërmjet shkresës nr. 6049/1 prot., datë 14.07.2017, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit, duke mos e marrë në shqyrtim ankesën pas sipas tij është paraqitur afateve ligjore.

II.4. Në datën 20.07.2017 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor.

II.5. Në datën 31.07.2017 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1312/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 6431/1 prot., datë 27.07.2017, me objekt: “Dërgim informacioni”, ku jepet informacion lidhur me pretendimet e ankimuesit si vijon:

“[...] Më datë 10.07.2017 autoriteti kontraktor Bashkia Lezhë ka shpallur në adresën www.app.gov.al prokurimin me objekt: “Shërbime printimi, fotokopjimi dhe skanimi kolor e bardh e zi format A4”. Në këtë datë është bërë publikimi i njoftimit të kontratës në adresën www.app.gov.al.

Në datën 14.07.2017 pranë Bashkisë Lezhë ka paraqitur ankesë operatori ekonomik PC Store, duke kërkuar modifikimin e kriterëve të vecanta të kualifikimit. Me marrjen e ankesës Bashkia Lezhë, në zbatim të nenit 63 të LPP-së, me urdhërin nr. 101, datë 14.07.2017 ka urdhëruar pezullimin e procedurës së prokurimit derisa ankesa të shqyrtohet plotësisht. Me shkresën nr.6049/1 prot., datë 14.07.2017 i kemi kthyer përgjigje, duke e refuzuar ankesën si të paraqitur jashtë afateve ligjore.

Ka qënë një lapsus refuzimi i ankesës për afate pasi ndryshimet e fundit në sistem kanë shtuar një kolonë që është publikimi i njoftimit nga ana e punonjësve të APP-së dhe nga ana jonë është parë kolona e parë e publikimit të njoftimit të kontratës nga ana jonë. Publikimi i njoftimit të kontratës nga autoriteti kontraktor është bërë në datë 07.07.2017 ndërsa

publikimi i njoftimit të kontratës nga APP është bërë në datën 10.07.2017. Llogaritja e afateve në kthimin e përgjigjes operatorit ekonomik PC Store është bërë duke ju referuar datës 07.07.2017.

Pasi konstatoam perlllogaritjen e gabuar të afateve nga ana jonë, përgatitëm draft përgjigjen e dytë por pas verifikimit në sistem të ankesave të KPP-së rezultoi se PC Store ishte ankimuar pranë jush. Për këtë arsye informacion të hollësishëm në lidhje me caktimin e kriterëve të vecanta kualifikuese po i detajojmë si më poshtë:

Në lidhje me pikën e parë të ankesës ku OE PC Store nuk është dakort me pikën 2 “Kriteret e vecanta”.

“Operatori ekonomik duhet të jetë distributor i autorizuar nga kompanitë prodhuese të markave XEROX dhe RICOH, për territorin e Republikës së Shqipërisë, kjo për arsye se pajisjet që disponon Bashkia Lezhë dhe njësitë administrative përbërëse janë pikërisht të këtyre markave”

Në vendosjen e këtij kriteri kemi patur parasysh faktin që në të gjitha njësitë administrative (9) të Bashkisë Lezhë dhe në drejtoritë përkatëse të Bashkisë janë instaluar përgjithësisht pajisje të markave XEROX dhe RICOH.

Në gjykimin e OE PC Store kriteri “Operatori ekonomik duhet të jetë distributori i autorizuar nga kompanitë prodhuese e markave XEROX dhe RICOH për territorin e Republikës së Shqipërisë, kjo për arsye se pajisjet që disponon Bashkia Lezhë dhe njësitë administrative përbërëse janë pikërisht të këtyre markave” kufizon konkurrencën, duke lejuar vetëm 1 kompani Kallfa sh.p.k e cila është distributori i vetëm për markat XEROX dhe RICOH në Shqipëri.

Sqarojmë se në përcaktimi e këtij kriteri njësia e prokurimit është mbështetur në VKM nr. 914, dt 29.12.2014 “Mbi miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 28, pika 5, gërma “a” ku shprehet:

- a) Licensat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

Pra ligjvënësi ka përcaktuar qartë se operatorët ekonomikë duhet të kenë licensa profesionale, pra në këtë rast, duke qenë se është procedura “shërbim” dhe pajisjet e vëna në dispozicion nga AK janë të markës RICOH dhe XEROX, kërkohet që shërbimi të kryhet nga kompanitë distributore të këtyre markave, për të arritur një shërbim me cilësi dhe cmim më të ulët pasi vetëm distributorët e autorizuar kanë servis të autorizuar dhe mund të importojnë direkt nga prodhuesi pjesët dhe lëndët e para të këmbimit për kryerjen e servisit të pajisjeve.

Përsa i përket kompanive, në dijeninë tonë janë disa distributorë që kanë licencën për distribuimin e pajisjeve dhe licencën e servisit të autorizuar për pajisjet e markave RICOH dhe XEROX në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Në lidhje me pikën e dytë të ankesës ku OE PC Store nuk është dakort me kriterin:

“Operatori ekonomik duhet të vërtettojë se ka të punësuar minimalisht 10 persona, nga këta 7 persona duhet të jenë me diploma inxhinie (IT, megatroni, inxhinier elektronik etj) për të cilët duhet të paraqesë:

1. CV personale
2. Diploma personale e fakultetit

3. *Kontrata e punës për secilin profil (me afat të paktën deri në përfundimin e shërbimit objekt prokurimi)”*

Ju informojmë se nr. i pajisjeve të instaluara në drejtoritë e bashkisë dhe njësitë administrative përkatëse nuk është numri i përcaktuar në ankesë, informacion krejt i pasaktë pa ditur burimin nga është nisur operatori ekonomik, pasi numri i pajisjeve XEROX dhe RICOH është shumë më i lartë, pasi janë gjithsej 9 njësi administrative dhe mbi 9 drejtori në bashki dhe për këtë arsye kemi vendosur kriterin që kompania fituese të ketë të paktën 10 persona nga këta 7 persona të jenë me diploma inxhinier, pasi stafi i kompanisë duhet të mirëmbajtë dhe të asistojë sa herë të ketë nevojë për funksionimin e këtyre pajisjeve.

Pajisjet janë të shpërndara në 9 njësi administrative dhe 4 godina në qytetin e Lezhës, pra pasja e 7 inxhinierëve si pjesë stafi është në koherencë të plotë me natyrën dhe vlerën e kontratës pasi janë 9 njësi administrative të shpërndara gjeografikisht dhe një qytet që do të shërbehet në cdo moment, pasi është vetë natyra e shërbimit i cili është tepër specifik ku cdo njësi administrative do të shërbehet brenda një kohe të caktuar pa iu ndërprerë puna.

Në lidhje me pikën e tretë të ankesës ku operatori ekonomik nuk është dakort me kriterin:

“Stafi i të punësuarve duhet të jetë i certifikuar për mirëmbajtjen e pajisjeve për markat e pajisjeve RICOH dhe XEROX. Certifikata e trajnimit për stafin teknik duhet të jetë lëshuar detyrimisht nga prodhuesi i markës RICOH dhe XEROX (3 specialistë të certifikuar për mirëmbajtjen e pajisjeve RICOH; 3 specialistë të certifikuar për mirëmbajtjen e pajisjeve XEROX).”

Njësia e prokurimit në caktimin e kriterit të mësipërm është mbështetur në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 28, pika 5, gërma “b” ku shprehet:

“një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla dhe/ose...”

Pra ligjvënësi shprehet qartë kur lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV dhe licencat profesionale kur kanë të tilla.

Duke patur parasysh që pajisjet që do të përdoren në këtë procedurë janë në pronësi të Bashkisë Lezhë, për të patur një shërbim me cilësi të vazhdueshëm, duke patur parasysh që pajisjet janë profesionale, nuk mund të pranojë që servisi dhe specialistët që do të merren me mirëmbajtjen e tyre të mos jenë të autorizuar dhe trajnuar nga prodhuesi i markave, pasi vetë mirëmbajtja e këtyre pajisjeve kërkojnë një kualifikim të tillë të personelit kryesor.

Prandaj për të patur garanci në marrjen e shërbimit AK kërkon garanci të cilat janë të shprehura qartë në VKM nr. 914, dt.29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publi”, neni 28, pika 5.

Ju bëjmë me dije se markat e pajisjeve të printimit të përdorura në këtë procedurë janë të prodhuesit RICOH/XEROX dhe nuk mund të ketë asnjë servis të autorizuar ose certifikatë ekuivalente të lëshuar dhe e njohur nga prodhuesit RICOH/XEROX për stafin që merret me mirëmbajtjen e pajisjeve.”

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese si dhe dokumentave e informacionit të dërguar nga autoriteti kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e ankimuesit sipas së cilës “*kërkesa e përcaktuar nga autoriteti kontraktor se “operatori ekonomik duhet të jetë distributor i autorizuar nga kompanitë prodhuese të markave XEROX dhe RICOH për territorin e Republikës së Shqipërisë”, kufizon konkurrencën, duke lejuar vetëm një numër të kufizuar shoqërisht të jenë pjesëmarrëse dhe më saktë nga vetën 1 (një) kompani “Kallfa” e cila është distributori i vetëm për markat XEROX dhe RICOH në Shqipëri [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.1.1. Në shtojcën 6 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, gërma “b”, rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kërkesës së mëposhtme:

b) Operatori ekonomik duhet të jetë distributor i autorizuar nga kompanitë prodhuese e markave XEROX dhe RICOH, për Territorin e Republikës së Shqipërisë, kjo për arsye se paisjet që disponon bashkia Lezhe dhe njesite administrative përbërëse janë pikërisht të këtyre markave.

III.1.2. Në shtojcën 1 “Formulari i ofertës” është parashikuar:

1	2	3	4	5	6
Nr	Përshkrimi i Shërbimeve	Sasia ne vit A4	Çmimi Njësi	Çmimi Total	Afati
1.	Printim/fotokopjim me ngjyra A4	30.000			
2.	Printim/fotokopjim bardh e zi	460.000			
Çmimi Neto)					
TVSH (%)					
Çmimi Total					

III.1.2. Në shtojcën 8 “Specifikimet teknike” të dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit, autoriteti kontraktor parashikuar kryerjen e shërbimeve si vijon:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

1. Shërbim Mirëmbajtje pajisje **RICOH** – (**MP 161 SPF, MP 171 SPF**)
Printim-Skanim-Fotokopjim: Format A4
2. Shërbim Mirëmbajtje pajisje **XEROX** – (*E tipit nr. 5222, nr. 5225, nr.5230*)

• **Specifikimet Teknike**

- *Shërbim të fotokopjeve në nivelin 100% gjatë gjithë periudhës së shërbimit – kjo përfshin çdo orë e ditë pune.*
- 1. Shërbimi përfshin pastrimin/ shërbimin periodik të të gjithë komponenteve të vegjël e të mëdhenj dhe kurdoherë është e nevojshme zëvendësimi i pjesëve të konsumit apo pjesëve të këmbimit.*
 - 2. Zhvilluesit / tonerët dhe pjesët e tjera të konsumueshme sigurohen nga kontraktori pa asnjë kosto shtesë (kosto do të jetë e përfshirë në çmimin për kopje).*

Fotokopjet do të mirëmbahen me të gjitha mënyrat dhe mjetet parandaluese të mosfunksionimit të saj, dhe për të parandaluar në kohe çdo lloj defekti i cili i bën të paoperueshme këto fotokopje (p.sh. mbarimi i tonerëve, cikli i jetës së fuserit (FK), cilindrit (MK), DP etj të matshme në mënyrë elektronike nga vete pajisja). Mirëmbajtja do të parashikojë punën e kujdesshme të kontraktorit për të riparuar sakte e pa gabime pajisjen dhe duke mos krijuar asnjë shkak të drejtpërdrejtë ose jo, për krijimin e qarqeve të shkurtra elektrike në pajisje të cilat mund të shkaktojnë djegie ose zjarr.

Shërbimi dhe riparimi i fotokopjeve do të behet me pjese origjinale të prodhuesit. Shërbimi do të jete minimalisht mujor, dhe i pranuar nga përdoruesi. Kontraktori duhet të sigurojë një pike kontakti me AK dhe të ketë një Helpdesk për të trajtuar të gjitha shqetësimet apo kërkesat për shërbim nga AK.

Koha e përgjigjes nga operatori do të jetë : Jo më vonë se ditën pasardhese të punes, pas njoftimit për asistence.

Në rastin e ndërprerjes së punës në fotokopje për më shumë se 24 ore, dhe defekti i konstatuar rezulton të jetë shumë i rëndë duke ndërprerë procesin e punës për më shumë se 48 ore në ditët e ardhshme, atëherë operatori ekonomik është i detyruar të pajisë me një fotokopje back-up (rezerve) për të kryer procesin normal të punës nga përdoruesi.

Gjithashtu stafi teknik që do të kryejë shërbimet duhet të jete i trajnuar nga prodhuesit dhe të ketë një përvojë pune në fushën e mirëmbajtjeve të pajisjeve fotokopjuese, offseteve, etj.

Operatori ekonomik në përfundim të kontratës duhet të garantojë AK se pajisjet do të jenë në gjëndje pune dhe pjesët e konsumit të kenë të pakonsumuar edhe 80 % të sasisë së tyre.

III.1.3. Në shtojcën 10 “Shërbimet dhe grafiku i ekzekutimit” të DT-ve është kërkuar kryerja e shërbimit si më poshtë:

Afatet e ekzekutimit: Nga momenti i lidhjes së kontrates, deri më 31.12.2017.

Operatori do të paguhet për sasinë e kryera të shërbimit për kopje A4.

<i>Sasia e printim/fotokopjimit – A4 me ngjyra</i>	<i>30.000 kopje A4</i>
<i>Sasia e printim/fotokopjimit - A4 bardh e zi</i>	<i>460.000 kopje A4</i>

III.1.4. Në shtojcën 11 "Termat e referencës" të dokumentave të tenderit është parashikuar:

Oëllimi

Bashkia Lezhe kërkon të realizojë shërbimin e mirembajtjes së pajisjeve RICOH dhe XEROX. Me realizimin e këtij shërbimi synohet sigurimi i kushteve normale të punës për punonjësit, nëpërmjet një shërbimi cilësor e të vazhdueshëm, duke eliminuar problematikat e shumta të gatishmërisë së tyre për shkak të defekteve të ndryshme dhe mungesës apo cilësisë së ulët të bojërave (tonerëve) që qarkullojnë në treg.

Objekti

Realizimi shërbimin të mirembajtjes së fotokopjeve RICOH dhe XEROX do të mundësojë kryerjen e printimit/ fotokopjimit/skanimit të materialeve shkresore të administratës, sipas përcaktimeve që janë bere në hartimin e termave të referencës.

Detyrat

Shërbimi i mirëmbajtjes konsiston në ofrimin e të gjitha pjesëve konsumuese të fotokopjes (zhvillues, cilindër, gomina etj) dhe të mirëmbajtjes nga ana teknike të pajisjes, dhe operatori ekonomik paguhet në bazë të faqeve të printuara/fotokopjuara nga pajisjet.

Fotokopjet janë të lidhura në rrjet dhe përdoren nga të gjithë punonjësit. Per shkak të volumit të punes pajisjet do të funksionojnë 24 orë pa ndërprerje dhe do të jenë të kompletuar me tonerë dhe pjesët konsumuese.

Shërbimi i mirembajtjes se fotokopjeve RICOH dhe XEROX do te përfshijë: mirembajtjen 24 ore te pajisjeve ne gjendje pune, furnizimin me tonerë, kryerjen e defekteve në cdo kohe, zëvendësimin e pjesëve të konsumit (cilindra, zhvillues etj) sipas përcaktimeve që vijnë më poshtë.

Vendi i kryerjes së shërbimeve

Bashkia LEZHE dhe njesite administrative

III.1.5. Në nenin 46 pika 1 gërma "b" të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" të ndryshuar, parashikohet se "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;

III.1.6. Në nenin 23 pika të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar parashikohet se:

"1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet

të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara. 2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. 3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar: a) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve; b) kërkesave në terma funksionalë, kur një gjë e tillë kërkon t'u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; c) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj. 4. Përshkrimi i punimeve, mallrave apo shërbimeve duhet të përmbajë specifikimet teknike, që duhet të plotësohen në rast nevoje, edhe plane, vizatime, modele, makete etj. Në rast të përshkrimit funksional të punimeve apo të mallit, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë në mënyrë të saktë dhe neutrale qëllimin e punimeve për njohjen e të gjitha kushteve dhe rrethanave me rëndësi për hartimin e ofertës. Nga përshkrimi i punimeve apo mallrave duhet të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale. Që të garantohet krahasueshmëria e ofertave për kërkesat e objektit të kontratës, për këto punime ose për funksionin e tyre, kërkesat e rendimentit dhe të funksionit duhet të jenë të sakta për t'u dhënë konkurruesve dhe ofertuesve një ide të qartë në përgatitjen e ofertës. Në përshkrimin e punimeve duhet të shënohen, kur është rasti, edhe specifikimet për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve, të përshtatshme për mjedisin. 5. Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët "ose ekuivalent" të përfshihen detyrimisht në këto specifikime."

III.1.7. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 28 "Kontratat e shërbimeve", pika 1 dhe 2, thuhet se:

"1. Natyra e shërbimeve duhet të shprehet qartë në termat e referencës, ku përfshihen objekti, qëllimi, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.

2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve."

Kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ato i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

III.1.8. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit për procedurën e mësipërme të prokurimit, lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “PC Store” sh.p.k rezulton se autoriteti kontraktor në objektin e prokurimit të mësipërm ka kërkuar kryerjen e shërbimeve të printimit, fotokopjimit dhe skanimit, color e bardh e zi në formatin A4, gjë cila është pasqyruar edhe në formularin e ofertës ku saktësohet që ofertuesit do të paraqesin cmimet e ofertave bazuar në realizimin e shërbimit “Printim/fotokopjim me ngjyra A4” për 30.000 kopje dhe “Printim/fotokopjim bardh e zi” (A4) për 460.000 kopje. Ndërkohë nga shqyrtimi i specifikimeve teknike dhe termave të referencës të kesaj procedure rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor kërkohet shërbimi i mirëmbajtjes së pajisjeve RICOH dhe XEROX, shërbimeve të cilat nuk janë pasqyruar në tabelën e formularit të ofertës, mbi bazën e të cilës përcaktohet edhe cmimi në total i ofertës.

Në këto kushte kërkesa e autoritetit kontraktor duhet të lidhet me faktin se paisjet që disponon Bashkia Lezhe dhe njesite administrative përbërëse janë të *markave XEROX dhe RICOH* dhe ndaj tyre do të kryhet jo vetëm shërbimi i printimit por edhe mirëmbajtja e tyre, shërbim i cili detyrimisht duhet të ishtë parashikuar dhe pasqyruar edhe në formularin e ofertës e për pasojë edhe në fondin limit. Pra vendosja e këtij kriteri është i lidhur me saktësimin e kërkesave të autoritetit kontraktor përsa i përket shërbimit të kërkuar. Nëse do të kërkohet vetëm kryerja e shërbimit të printimit sic është parashikuar në formularin e ofertës dhe në objektin e prokurimit: *“Shërbime printimi fotokopjimi dhe skanimi, color e bardh e zi format A 4”*, kërkesa e autoritetit kontraktor është në hartuar në tejkallim të objektivit të prokurimit. Por nëse autoriteti kontraktor kërkon krahas shërbimit të printimit, skanimit, fotokopjimit edhe mirëmbajtjen e pajisjeve përkatëse, atëherë nga ana e këtij të fundit duhet të parashikohen shërbimet konkrete të mirëmbajtjes gjë e cila detyrimisht do të pasqyrohet edhe në formularin e ofertës dhe rrjedhimit edhe në fondin limit.

Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor në hartimin e kriterëve të vecanta të kualifikimit duhet të ketë parasysh elementë të tilla si mosdiskriminimi, proporcionaliteti, dobishmëria dhe nevojat, të gjitha në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kërkesat në fjalë duhet të përputhen me objektin e prokurimit, sic është përshkruar edhe në specifikimet teknike dhe termat e referencës të dokumentave të tenderit. Komisioni gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapacitetëve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

Pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.1.9. Lidhur me kërkesën e ankimuesit për shtimin e kriterëve të kualifikimit, dhe paraqitjen e certifikatave të mëposhtme: *a) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë*

certifikatën e tij që vërteton se sistemi i manaxhimit të cilësisë është sipas standardit ISO 9001:2008, objekti i së cilës të ketë lidhje me objektin e prokurimit; b) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën ISO 27001 për sigurinë e informacionit. Objekti i certifikatës duhet të jetë i ngjashëm me objektin e prokurimit, si dhe shtimin e kërkesës për autorizimin e prodhuesit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.9.1. Në nenin 12 pika 1 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar parashikohet se: “Autoriteti kontraktor është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij”

III.1.9.2. Në nenin 19/1 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar parashikohet se: “Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj”

III.1.9.3. Në nenin 63 pika 1 dhe 1.1 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar parashikohet se:

Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.

Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik.

III.1.9.4. Në nenin 64 pika 3 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar parashikohet se:

Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor ka shkelur ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë:

- a) të nxjerrë një interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës;
- b) të anulojë, plotësisht ose pjesërisht, një veprim ose vendim të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato specifikime teknike ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj;
- c) të udhëzojë autoritetin kontraktor të korrigojë shkeljet dhe më pas të vazhdojë me procedurën e prokurimit të kontratës;
- ç) të urdhërojë anulimin e procedurave për shpalljen e kontratës fituese.

III.1.9.5. Në nenin 28 pika 1 dhe 2 të Vendimit nr. 184, datë 17.03.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar” parashikohet se :

1. Komisioni, pas shqyrtimit administrativ të ankesës vendos me akt të motivuar:

a) Pushimin e procedimit administrativ për shkak se veprimet e treguara në ankesë nuk përbëjnë shkelje të legjislacionit mbi prokurimin publik apo kur pretendimet e ankuesit rezultojnë të paprovuara; ose

b) Ndalimin e autoritetit kontraktor të vazhdojë veprimet e paligjshme, duke i caktuar një afat kohor.

2. Nëse Komisioni vendos sipas pikës 1 shkronjës “b” të këtij neni me arsyetimin se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor është në kundërshtim me ligjin 9643/2006, dhe kontrata e prokurimit ende nuk është lidhur, atëherë Komisioni ka të drejtë:

- a) Të interpretojë rregullat ose parimet ligjore që duhet të zbatohen për objektin e ankesës, duke udhëzuar autoritetin kontraktor të veprojë sipas këtij interpretimi në vazhdimin e procedurës së prokurimit;
- b) Të anulojë plotësisht ose pjesërisht vendimin ose veprimin e autoritetit kontraktor të nxjerrë në kundërshtim me ligjin, si dhe të udhëzojë vazhdimin e procedurës së prokurimit në përputhje me ligjin, duke treguar veprimet që duhet të kryhen në vijim;
- c) Të konstatojë shkeljen ligjore konkrete dhe të udhëzojë autoritetin kontraktor mbi korrigjimin e tyre, si dhe për vazhdimin e procedurës së prokurimit;
- d) Të anulojë procedurat për shpalljen e kontratës fituese dhe të udhëzojë autoritetin kontraktor për rifillimin e procedurës së prokurimit.

III.1.9.6. Në nenin 57 pika 2 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se : “ Njësia e prokurimit është përgjegjëse për:

- sigurimin e të dhënave të nevojshme nga strukturat përkatëse në institucion dhe përgatitjen e regjistrimit të parashikimit dhe regjistrimit të realizimit të procedurave të prokurimit publik;
- përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit (dhe justifikimin kur është rasti);
- përlllogaritjen e fondit limit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme;
- hartimin e urdhrimit të prokurimit;
- përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme që u bashkëlidhen atyre, përfshirë hartimin e kritereve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme;
- hartimin dhe dërgimin e njoftimeve për publikim, brenda afateve kohore;
- administrimin e të gjitha procesverbaleve për dokumentet e tenderit dhe çdo dokument tjetër, që lidhet me procedurat e përcaktimit të fituesit, duke përfshirë edhe procesverbalet e mbledhjeve, kur është rasti;
- llogaritjen e çmimeve të shitjes së dokumenteve të tenderit që u jepen operatorëve ekonomikë me kërkesë të tyre, kur është rasti.”

III.1.9.7. Referuar metodës së interpretimit sistematik (domethenjen e drejtë të normës juridike duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik), Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ka një ndarje të qartë mes rolit të tij të paraparë nga ligji si organi më i lartë i shqyrtimit të ankesave në fushën e prokurimeve publike (neni 19/1 e vijues i LPP-së) dhe autoriteteve kontraktore si organ përgjegjës i zhvillimit të procedurave të prokurimit (neni 12 i LPP-së) dhe njëherazi përgjegjës për hartimin e kritereve të veçanta të kualifikimit për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik. Në nenin 63 pika 1.1. të LPP-së, parashikohet se “Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik.” KPP gjykon se, që të justifikohet ligjërisht kërkimi për njohjen ose rivendosjen e një të drejte të shkelur ose të mohuar duhet që të bëhet vetëm prej atij që i përket, sipas ligjit, e drejta e mohuar ose e shkelur prej një të treti dhe vetëm kundër atij që me faktin ose me

veprën e tij mohon ose shkel të drejtën e kërkuar (legjitimimi pasiv), duke justifikuar me këtë fakt ose veprim ndërhyrjen e organit administrativ për të ndaluar ose për të zhdukur dëmin e rrjedhur nga ky fakt, ose veprimeve (legitimation ad causam), pra operatori ekonomik ankimues duhet të provojë se interesi i tij i ligjshëm është çenuar nga vendime dhe veprime konkrete (reale) të autoritetit kontraktor. Në rastin konkret, KPP gjykon se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar mekanizmat ligjorë për kundërshtimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit pranë këtij të fundit, duke dhënë garanci të plota operatorëve ekonomikë ankimues se procedurave për fitimin e kontratave publike, do ti nënshtrohet kushteve specifike (kriterëve të veçanta të kualifikimit), të cilat duhet të përmbushin parakushtin sine qua non të parashikuar nga neni 46 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, duke qenë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese. Në rastin konkret, KPP gjykon se njësia e prokurimit pranë autoritetit kontraktor ka parashikuar kriteret minimale kualifikuese, të gjykuar të nevojshëm për vërtetimin e plotësisht të kapacitetit teknik të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi. Kuadri ligjor në fuqi, ka paraparë pozitën juridike të Komisionit të Prokurimit Publik, si organ i shqyrtimit të ankesave kundër vendimeve të shprehura me akte administrative (dokumentet e procedurës së prokurimit) duke i dhënë të drejtën ligjore të shprehet mbi kriteret kualifikuese dhe specifikimet teknike në rast se këto të fundit janë hartuar në përputhje me ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe kuadrin ligjor sektorial në fuqi që rregullon kontratën objekt prokurimi. Kompetenca e mësipërme është shprehur në disa drejtime në ligjin për prokurimin publik në fuqi, ku nën nenin 63 pika 4 gërma “b” të lex specialis parashikohet se ndër kompetencat e Komisionit të Prokurimit Publik janë ato të anulimit, plotësisht ose pjesërisht, një veprimi ose vendimi të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato specifikime teknike ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj. Në rastin konkret, KPP gjykon se objekti i ankesës së operatorit ekonomik ankimues nuk lidhet me kundërshtimin e një vendimi të shprehur nga ana e autoritetit kontraktor (verifikimin ligjor në rast se kriteret kualifikuese janë në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës, apo në rast se specifikimet teknik janë hartuar në formën e kërkuar nga ligji), por mbi shtimin e kriterëve kualifikuese në një procedurë prokurimi. Sa më sipër, KPP gjykon se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar se është në të drejtën e plotë të autoritetit kontraktor të parashikojë kriteret minimale kualifikuese në një procedurë prokurimi dhe në rast se këto të fundit, (vetëm kriteret e shprehura dhe jo ato hipotetike të kërkuara) nuk janë në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi, jepet garancia procedurale e paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik. KPP në asnjë rast nuk mund të marrë kompetencat e autoritetit kontraktor (njësisë së prokurimit) të shtojë kriteret të tjera kualifikuese për marrjen pjesë në procedurat e prokurimit publik.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e ankimuesit se: “[...] Duke parë se lista e pajisjeve në përdorim nga AK, janë gjithsej:

- RIKOH- (MP 161 SPF, MP 171 SPF) -- 2 copë

- XEROX- (e tipit nr.5222, nr.5225, nr.5230) -- 3 copë

Pra në total janë 5 (pesë pajisje) dhe duhet në total 7 inxhiniera (IT, megatronik, inxhinier elektronik etj.) nuk është në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 6 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, gërma “c”, rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kërkesës së mëposhtme:

c) Operatori ekonomik duhet te vertetoje se ka te punesuar minimalisht 10 persona, nga keta 7 persona duhe te jene me diploma inxhinier (IT, megatronik, inxhinier elektronik etj) per te cilet duhet te paraqese:

1. CV personale
2. Diploma personale e fakultetit.
3. Kontrata e punes per secilin profil (me afat, te pakten, deri ne perfundim te sherbimit objekt prokurimi).

III.2.2. Në nenin 46, pika 1 gërma “a” dhe “b” ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “[...]1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata; b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; [...]”

III.2.3. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 28 “Kontratat e shërbimeve”, pika 2, thuhet se:

“ 2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Ndërsa në pikën 5, të kësaj dispozite thuhet:

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose

c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushurkontratën.

III.2.4. Në lidhje me kundërshtimin e mësipërm të operatorit ekonomik ankimues, mbi modifikimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit përsa i përket numrit të inxhinierëve, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është me vend të ndalet në një test balancues të dy elementëve kryesorë. Së pari, nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. Gjithashtu, në shqyrtimin e kriterit të mësipërm të kualifikimit, K.P.P. gjykon të ndalet edhe në faktin nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së.

III.2.5. Në shtojcën 11 “*Termet e Referencës*” së procedurës së prokurimit objekt ankimi autoriteti kontraktor ka parashikuar se “*Shërbimi i mirëmbajtjes konsiston në ofrimin e të gjitha pjesëve konsumuese të fotokopjes (zhvillues, cilindër, gomina etj) dhe të mirëmbajtjes nga ana teknike të pajisjes, dhe operatori ekonomik paguhet në bazë të faqeve të printuara/fotokopjuara nga pajisjet. Fotokopjet janë të lidhura në rrjet dhe përdoren nga të gjithë punonjësit. Per shkak të volumit të punës pajisjet do të funksionojnë 24 orë pa ndërprerje dhe do të jenë të kompletuar me tonerë dhe pjesët konsumuese. Shërbimi i mirëmbajtjes se fotokopjeve RICOH dhe XEROX do të përfshijë: mirëmbajtjen 24 ore të pajisjeve në gjendje pune, furnizimin me tonerë, kryerjen e defekteve në cdo kohe, zëvendësimin e pjesëve të konsumit (cilindra, zhvillues etj) sipas përcaktimeve që vijojnë më poshtë..”*

Njëkohësisht, autoriteti kontraktor në “*Formularin e ofertës*” dhe në shtojcën “*Shërbimet dhe grafiku i ekzekutimit*” ka parashikuar: “*Printim/fotokopjim me ngjyra A4- 30.000 kopje dhe Printim/fotokopjim bardh e zi - 460.000 kopje A4*”. Afati i ekzekutimit është nga momenti i lidhjes së kontratës, deri më 31.12.2017

III.2.6. KPP nënvizon se autoritetet kontraktore në hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit duhet të parashikojnë këto të fundit në proporcion me natyrën dhe volumin e procedurës së prokurimit objekt ankimi. Në rastin konkret K.P.P. konstaton se synimi bazë i autoritetit kontraktor (referuar njëherazi edhe proces-verbalit të miratimit të dokumenteve të tenderit) është vërtetimi se subjektet ofertues zotërojnë stafin e duhur për kryerjen e shërbimit të kërkuar në përputhje me kohëzgjatjen e parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit dhe njëherazi në përputhje me cilësinë e kërkuar.

Sa më sipër, KPP gjykon se në përgjigje të testit të proporcionalitetit të mësipërme, kërkimi i autoritetit kontraktor mbi disponueshmërinë e 7 personave të cilët duhet të jenë me diploma inxhinier (IT, megatronik, inxhinier elektronik etj), është një kërkesë e cila nuk është në përputhje me natyrën dhe objektin e shërbimeve dhe shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme. Për këto arsye, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë dokumentat e

procedurës së prokurimit objekt ankimi duke ulur këtë numër në përputhje me natyrën dhe volumin e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.2.7. Gjithashtu Komisioni I Prokurimit Publik konstaton se në pretendimet e ngritura në pikën 2 të ankesës, sikurse janë parashtruar në Seksionin II “Rrethanat e çështjes” të këtij vendimi ankimuesi ka kërkuar përvec modifikimit të numrit të punonjësve sikurse u trajtuar në pikën III.2 të arsyetimit edhe heqjen e kërkesës së autoritetit kontraktor për kontratat e punës, por pa parashtruar asnjë argument përse i përket këtij pretendimi. Referuar VKM nr. 184, datë 17.03.2010, *“Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe “elementet e domosdoshëm të ankesës” sipas përcaktimeve të nenit 17, “Forma dhe përmbajtja e ankesës”, pika 3:*

- *Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni;”*

Përse më sipër operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon kërkesën për heqjen e kushtit për kontratat e punës, pasi është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij, ndaj dhe kjo kërkesë nuk do të merren në shqyrtim nga KPP.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “PC Store” sh.p.k sipas së cilës: *“Vendosja e kriterëve (3 Specialistë të certifikuar për mirëmbajtjen e pajisjeve RICOH; 3 Specialistë të certifikuar për mirëmbajtjen e pajisjeve XEROX) nuk është në përpjestim me sasinë e pajisjeve duke qenë se në total janë 5 pajisje. Referuar nenit 23 të LPP-së AK duhet të shtojë togfjalëshin “ose ekuivalent” duke mundësuar një konkurrim t drejtë të hapur dhe gjithpëfshirës [...]. Në këtë kuptim AK duhet të modifikojë kriterin si vijon: “Stafi i të punësuarve duhet të jetë i certifikuar për mirëmbajtjen e pajisjeve për markat e pajisjeve RICOH dhe XEROX ose “ekuivalente”. Certifikatat e trajnimit për stafin teknik duhet të jetë lëshuar detyrimisht nga prodhuesi i markës RICOH dhe XEROX ose “ekuivalent”, Komisioni i Prokurimit Publik i qëndron të njëjtit gjykim të dhënë në pikën “III.1.1” – “III.1.8” të arsyetimit sipas të cilit vendosja e këtij kriteri është i lidhur me saktësimin e kërkesave të autoritetit kontraktor përse i përket shërbimit të kërkuar, pra nëse do të kërkohet vetëm kryerja e shërbimit të printimit sic është parashikuar në formularin e ofertës dhe në objektin e prokurimit: “Shërbime printimi fotokopjimi dhe skanimi, color e bardh e zi format A 4”, kërkesa e autoritetit kontraktor është në hartuar në tejkalim të objektit të prokurimit. Por nëse autoriteti kontraktor kërkon krahas shërbimit të printimit, skanimit, fotokopjimit edhe mirëmbajtjen e pajisjeve përkatëse, atëherë nga ana e këtij të fundit duhet të parashikohen shërbimet konkrete të mirëmbajtjes gjë e cila detyrimisht do të pasqyrohet edhe në formularin e ofertës dhe rrjedhimisht edhe në fondin limit.*

Pretendimi i ankimuesit qëndron.

Në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri:

Vendos

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “PC Store” sh.p.k. për procedurën e prokurimit me Nr.REF-19873-07-07-2017 me objekt: “*Sherbime printimi fotokopjimi dhe skanimi, color e bardh e zi format A 4*”, me fond limit limit 1.658.000 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 20.07.2017 nga autoriteti kontraktor Bashkia Lezhë.
2. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentat e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi në përputhje me parashikimet e Vendimit nr.482 datë 05.07.2017 të Këshillit të Ministrave “*Për Pezullimin e Përkohshëm të Procedurave të Prokurimit, për Vitin 2017*”
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “PC Store” sh.p.k .
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1312 Protokolli,

Datë 20.07.2017

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha